



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 188/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.04.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Arisa Konfeksion” dhe “Malbertex” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur, me Nr. REF-78186-11-10-2020, me objekt “Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës”, me fond limit 18,000,120 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: “Gentian Sadiku” P.F
Adresa: Rruga “Tom Plezha”, Pallati “Milo”, Nr.7.
Yzberisht, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Adresa: Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik

nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.11.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit *“Procedurë e Hapur, me Nr. REF-78186-11-10-2020, me objekt “Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës”, me fond limit 18,000,120 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.*

II.2. Në datën 04.12.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 15.12.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Euro 2001" shpk	13.294.680 lekë	I skualifikuar
2. "Atlantik 3" shpk	14.074.400 lekë	I skualifikuar
3. "Arisa Konfeksion" shpk	14.988.000 lekë	I kualifikuar
4. "Malbertex" shpk	17.210.700 lekë	I kualifikuar
5. "Gentian Sadiku" P.F	17.399.400 lekë	I kualifikuar

II.4. Në datën 21.12.2020 operatori ekonomik "Gentian Sadiku" shpk ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

Më datë 15.12.2020 me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), jemi njohur me klasifikimin e shoqërive pjesëmarrëse që kanë paraqitur ofertë në procedurën me objekt "Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës" si më poshtë:

1. "Euro 2001" shpk	13.294.680 lekë	I skualifikuar
2. "Atlantik 3" shpk	14.074.400 lekë	I skualifikuar
3. "Arisa Konfeksion" shpk	14.988.000 lekë	I kualifikuar
4. "Malbertex" shpk	17.210.700 lekë	I kualifikuar
5. "Gentian Sadiku" P.F	17.399.400 lekë	I kualifikuar

Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...". Në nenin 27 "Kontratat e mallrave", pika 3, e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se: "Kërkesat e vecanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në cdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".

Ndërsa në pikën 6 të nenit 27 "Kontratat e mallrave", të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se: "Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të

dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për verësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Pra, nga AK, kërkohen mostra të mallrave, pasi rrjedhimisht kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

Ne besojmë që AK nuk e ka zbatuar këtë pikë pasi të dy OE Arisa Konfeksion dhe Malbertex shpk që ishin prezent ditën dhe orën e hapjes së ofertave me mostra të mallrave nuk i kanë sjellë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë AK në DT për artikullin xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë, xhup i shkurtër, dhe kapele me gradë gjenerali, të tre këto artikuj –mostra të paraqitur nga këta operator ekonomik nuk përputhen aspak me specifikimet teknike të kërkuara në DT. Kjo vërehet shumë lehtë dhe me shikim të lirë pa qenë ekspert duke bërë krahasimin e mostrës fizike me specifikimin e shkruar por KVO ka vlerësuar vetëm dokumentat ligjore pa bërë verifikimin e paraqitjes së mostrave nga OE. Kjo shkelje e KVO nuk i ka shërbyer një procesi të mirëfilltë vlerësimi ku në këtë rast të dy OE Arisa Konfeksion dhe Malbertex shpk nuk janë në gjendje të përgatisin katër mostra të sakta.

Në dokumentat e tenderit, Kreu II Udhezime për operatorët ekonomike, Seksioni 1 “Hartimi i Ofertës”, është përcaktuar shprehimisht: “Operatorët Ekonomike janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

Së bashku me ofertat e tyre OE duhet të paraqesin edhe deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, të detyrueshme për tu plotësuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të dokumentave të tenderit dhe që duhet të firmosen nga ana e tyre si angazhim konkret për furnizimin e mallrave me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara në DT.

Pra duke qenë se këta dy OE kanë firmosur një deklaratë të tillë, rrjedhimisht detyrohen të përgatisin edhe mostrat e kërkuara sipas specifikimeve teknike. Duke qenë se mostrat nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë ju në DT rrjedhimisht të con në skualifikimin e këtyre dy OE.

II.4.1. Në datën 23.12.2020 me shresën nr. 2492/3 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.4.2. Në datën 30.12.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me argumentat si më poshtë:

Më datë 15.12.2020 me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), jemi njohur me klasifikimin e shoqërive pjesmarrëse që kanë paraqitur ofertë në procedurën me objekt “Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës” si më poshtë:

1. “Euro 2001” shpk	13.294.680 lekë	I skualifikuar
2. “Atlantik 3” shpk	14.074.400 lekë	I skualifikuar
3. “Arisa Konfeksion” shpk	14.988.000 lekë	I kualifikuar
4. “Malbertex” shpk	17.210.700 lekë	I kualifikuar
5. “Gentian Sadiku” P.F	17.399.400 lekë	I kualifikuar

Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”. Në nenin 27 “Kontratat e mallrave”, pika 3, e VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Kërkesat e vecanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në cdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Ndërsa në pikën 6 të nenit 27 “Kontratat e mallrave”, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për verësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) deshminë e origjinalitetit të mostrave, përkshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për

rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

Pra, nga AK, kërkohen mostra të mallrave, pasi rrjedhimisht kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

Ne besojmë që AK nuk e ka zbatuar këtë pikë pasi të dy OE Arisa Konfeksion dhe Malbertex shpk që ishin prezent ditën dhe orën e hapjes së ofertave me mostra të mallrave nuk i kanë sjellë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë AK në DT për artikullin xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë, xhup i shkurtër, dhe kapele me gradë gjenerali, të tre këto artikuj –mostra të paraqitur nga këta operator ekonomik nuk përputhen aspak me specifikimet teknike të kërkuara në DT. Kjo vërehet shumë lehtë dhe me shikim të lirë pa qenë ekspert duke bërë krahasimin e mostrës fizike me specifikimin e shkruar por KVO ka vlerësuar vetëm dokumentat ligjore pa bërë verifikimin e paraqitjes së mostrave nga OE. Kjo shkelje e KVO nuk i ka shërbyer një procesi të mirfilltë vlerësimi ku në këtë rast të dy OE Arisa Konfeksion dhe Malbertex shpk nuk janë në gjendje të përgatisin katër mostra të sakta.

Në dokumentat e tenderit, Kreu II Udhezime për operatorët ekonomike, Seksioni 1 “Hartimi i Ofertës”, është përcaktuar shprehimisht: “Operatorët Ekonomike janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

Së bashku me ofertat e tyre OE duhet të paraqesin edhe deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, të detyrueshme për tu plotësuar nga operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të dokumentave të tenderit dhe që duhet të firmosen nga ana e tyre si angazhim konkret për furnizimin e mallrave me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara në DT.

Pra duke qenë se këta dy OE kanë firmosur një deklaratë të tillë, rrjedhimisht detyrohen të përgatisin edhe mostrat e kërkuara sipas specifikimeve teknike. Duke qenë se mostrat nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë ju në DT rrjedhimisht të con në skualifikimin e këtyre dy OE.

Përgatitja e mostrave kërkon kohë mund por ka edhe kosto financiare. Subjekti jonë i ka përgatitur në mënyrë rigorozë cdo mostër të kërkuar nga ana juaj dhe si përfundim as nuk merret mundësia të vlerësohen nëse përmbushin kriteret sipas specifikimeve teknike të vendosura në DT.

Kërkojmë rivlerësim të ofertave duke shqyrtuar mostrat e mallrave të sjella fizikisht (që i cituam më sipër) pranë jush dhe skualifikimin e OE Arisa Konfeksion dhe Malbertex shpk në këtë procedurë prokurimi pasi nuk përmbushin kriteret përcaktuese nga AK.

Pranë KVO të Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara ne kemi kërkuar të verifikohen mostrat fizike dhe jo ato të testeve laboratorike duke qenë se problemi është në mostrat fizike të këtyre dy operatorëve pasi nuk janë sipas specifikimeve të kërkuara në DT përkatësisht:

- 1. Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës. Materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët që nuk janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DT.*
- 2. Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral. Dimensionin dhe dekoracionin i saj nuk përmbush kërkesat e specifikimeve pasi streha duhet të ketë 2 rreshta dekoracion (formë gjethe lisi) sic është përcaktuar në specifikim. Të dy këta OE nuk e kanë paraqitur kapelen sic është e specifikuar në DT.*
- 3. Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës. Materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, xhepat e përparëm, pjesa e pasme, bordurat e poshtme, manshetat që nuk janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DT. (Specifikimet teknike në DT janë të cituara se si duhet të jenë). Lutemi dhe KPP të verifikojë fizikisht mostrat pasi këto dallime verifikohen shumë lehtë edhe me shikim të lirë.*

Nëse specialistët pranë jush nuk janë të specializuar për të vlerësuar mostrat ashtu sic duhet atherë le të dorëzohen pranë specialistëve të duhur që ndodhen pranë institucionit që ka bërë kërkesën për këto mallra që është Garda e Republikës.

Referuar dhe një vendimi të KPP nr. 526/2016 në bazë të ankesës të së cilës kërkohet analizimi i mostrave fizike pasi artikuj të caktuar nuk janë sipas përmasave të duhura sic kërkohet nga AK ku ankimes është kompania tjetër e jona është një vendim i unifikuar nga ana juaj. Pasi janë bërë vlerësimet e mostrave fizike është konstatuar ky problem.

Ndodh që OE të caktuar sajojnë mostra për tu paraqitur pranë AK të ndryshëm dhe në fund kualifikohen pasi nuk bëhet vlerësimi i duhur i tyre. Duke qenë se nuk mundohen as në kohë apo në vlerë monetare për të përgatitur mostrat sipas kërkesave në DT dorëzojnë mostra që kushtojnë më lirë dhe ulin dhe ofertat për të dalë të parët në renditje. Ne që bëjmë një analizë të mirfilltë duke u bazuar tek kërkesat sipas specifikimeve teknike rrjedhimisht ofrojmë një cmim më të lartë pasi ajo është kosto reale e atyre artikujve dalim të fundit në renditje dhe as nuk na merret parasysh kur kërkojmë verifikim mostrash pranë AK.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 27/1 prot datë 12.01.2021 protokolluar me tonën me nr. 1826/2 prot datë 13.01.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Nëpërmjet shkresës Nr.prot 1826/5, datë 19.02.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Universitetit Politeknik të Tiranë, Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Departamentit të Tekstilit dhe Modës, duke i kërkuar shprehimisht si vijon:

“Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatojmë se nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, përveç të tjerave, janë paraqitur mostra të veshjeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktet:

- 1. Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës.*
- 2. Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral.*
- 3. Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës.*

Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neneve 80,81 dhe 86 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 24 pika 2 të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si edhe Vendimit Nr.867 datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, kërkojmë nga ana juaj informacion nëse institucioni juaj ka Inxhinier Tekstili për të kryer vlerësimin teknikisht dhe vizualisht të mostrave të mësipërcituara nëse ato janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit nëse po mund të na vini në dispozicion një Inxhinier Tekstili për ekzaminimin e mostrave të mësipërcituara. Gjithashtu në rast të një përgjigje pozitive, kërkojmë nga ana juaj të na informoni mbi koston apo tarifat, të cilat do të mbulohen nga ankimuesi”.

II.7. Në datën 04.03.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1826/6 prot., shkresa e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rektorati, me nr. 299/3 prot., datë 02.03.2021 me objekt: “Kthim përgjigje”, me përmbajtjen si më poshtë *“Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 1826/5 prot, datë 19.02.2021, nëse institucioni ynë ka inxhinier tekstil për të kryer vlerësimin teknikisht dhe vizualisht të mostrave të veshjeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, të cituara në shkresën tuaj, ju bëjmë me dije se propozimi ynë është z. G. G”.*

II.8. Nëpërmjet shkresës Nr.prot 1826/7, datë 08.03.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Universitetit Politeknik të Tiranë, Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Departamentit të Tekstilit dhe Modës, duke i kërkuar shprehimisht si vijon:

“Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatojmë se nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë, në përmbushje të kriterëve

kualifikuese, përvec të tjerave, janë paraqitur mostra të veshjeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor për produktet:

1. Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës.
2. Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral.
3. Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës.

Për mostrat e sipërcituara të paraqitura nga operatorët ekonomik pjesmarrës në këtë procedurë ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimues në lidhje me mospërputhjen e mostrave fizike të paraqitura nga operatorët ekonomik të kualifikuar me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, më konkretisht:

1. Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës. Materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët nuk janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DT.
2. Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral. Dimensionin dhe dekoracionin e saj nuk përmbush kërkesat e specifikimeve pasi streha duhet të ketë 2 rreshta dekoracion (formë gjethe lisi) sic është përcaktuar në specifikim. Të dy këta OE nuk e kanë paraqitur kapelen sic është e specifikuar në DT.
3. Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës. Materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, xhepat e përparëm, pjesa e pasme, bordurat e poshtme, manshetat nuk janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DT. (Specifikimet teknike në DT janë të cituara se si duhet të jenë).

Sa më sipër, në zbatim të nenit 19/1 dhe 64/1 gërma “ç”, e vijues të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neneve 80, 81 dhe 86 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 24 pika 2 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, Vendimit Nr. 867 datë 10.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, si dhe Vendimit të Komisionit Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, kërkojmë nga ana juaj të na informoni mbi koston apo tarifat e ekzaminimeve të mësipërcituara, të cilat do të mbulohen nga ankimuesi. Bashkangjitur shkresës po ju vëmë në dispozicion një kopje të specifikimeve teknike për mostrat mbi të cilat ngrihen pretendime”.

II.9. Në datën 16.03.2021 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1826/8 prot., shkresa e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rektorati, Drejtoria e Shërbimeve ndaj të tretëve me nr. 409/3 prot., datë 11.03.2020 me objekt: “Informacion mbi disponimin e laboratorëve të akredituar dhe të çertifikuar”, me përmbajtjen si më poshtë “Në përgjigje të

shkresës tuaj me nr. 1826/7, datë 08.03.2021, me anë të së cilës kërkon informacion pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, nëse ky i fundit disponon laboratorë, i cili të kryejë matjen e përmasave të mostrave si vijon:

1. Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës.
2. Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral.
3. Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës.

Gjeni bashkëngjitur shkresën e Fakultetit të Inxhinerisë Mekanike, ku konfirmohet se disponojmë laborator të akredituar për kryerjen e testimeve të kërkuara dhe gjithashtu tarifën për shërbimin e kërkuar. Pasi u njohëm me specifikimet teknike të veshjeve dhe shkresën Nr. 1826/7, datë 08.03.2021 të Komisionit Prokurimit Publik, sa i takon ekzaminimeve të këtyre objekteve dhe në zbatim të tarifave të miratuara nga Këshilli i Administrimit (sot Bordi Administrimit) të UPT, për testimet në Laboratorin Fiziko Mekanik dhe Kimik të Tekstilit dhe Lëkurës, ju vëmë në dijeni se tarifa për këtë shërbim është: $15 \text{ zëra testimesh} \times 1000 \text{ lekë} = 15\,000 \text{ lekë pa tvsh}$.

II.10. Njëpërmjet Vendimit Nr. 1826/7 Protokolli, datë 18.03.2021, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi si vijon:

1. Të urdhëroj kryerjen e ekspertizës për ekzaminimin, analizimin fiziko mekanike për mostrat Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë "Arisa Konfeksion" shpk dhe "Malbertex" shpk, nga laborator i akredituar i Universitetit Politeknik të Tiranës, për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur, me Nr. REF-78186-11-10-2020, me objekt "Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës", me fond limit 18,000,120 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
2. Të ekzaminohen, testohen mostrat Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, dhe Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës.
 - Per zerin Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, të ekzaminohet mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, për të cilat operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk janë qepur sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit, nga operatorët "Arisa Konfeksion" shpk dhe "Malbertex" shpk.
 - Per zerin Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, të ekzaminohet dimensionin dhe dekoracionin i kapeles pasi nuk përmbushin specifikimet teknike, pasi streha duhet të ketë 2 rreshta dekoracion në (formë gjethe lisi), siç është përcaktuar

në specifikimet teknike të dokumentave standarte të tenderit, nga operatorët “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk.

- *Per zerin Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës, të ekzaminohen materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, xhepat e përparëm, pjesa e pasme, bordurat e poshtme si dhe manshetat, pasi nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit, nga operatorët “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk.*
- 3. *Operatori ekonomik “Gentian Sadiku” P.F, të parapaguajë për llogari të Universitetit Politeknik të Tiranës, shumën e përcaktuar nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës nëpërmjet shkresës nr. 409/3 prot datë 11.03.2021 protokolluar me tonën me shkresën nr. 1826/8 prot, datë 16.03.2021, për 15 zëra shërbimi në shumën prej 15.000 lekë pa tvsh në total për testimin e mostrave të dorëzuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 23.03.2021 ora 12:00.*
- 4. *Në datën 23.03.2021 ora 12:00 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara dhe të operatorëve ekonomikë “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk me autorizim të posaçëm të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.*
- 5. *Të njoftojë laboratorin e Universitetit Politeknik të Tiranës për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.*
- 6. *Bashkangjitur vendimit do të gjënden edhe një kopje e specifikimeve teknik të procedurës së prokurimit objekt ankimi për mostrat e kontestuara.*

II.11. Në datën 23.03.2021 ora 12.10, u mbajt seanca dëgjimore në KPP, në prani të përfaqësuesve të shoqërisë “Gentian Sadiku” P.F, në mungesë, shoqërisë “Arisa Konfeksion” shpk shoqërisë “Malbertex” shpk, përfaqësuesit të autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara dhe të Komisionit të Prokurimit Publik. Në këtë seancë dëgjimore u dakortësua nga palët e pranishme që mostrat “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës”, të paraqitura nga operatorët ekonomik “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk, ti nënshtrohen procesit të ekzaminimit nga inxhinierët tekstil pranë Fakultetit të Inxhinieris Mekanike të Universiteti Politeknik të Tiranës. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik vendosi që brenda datës 25.03.2021 të përgatitet materiali për të dorëzuar mostrat për analizim në Laboratorin e U.P.T-së.

Nëpërmjet shkresës nr. 444/1 prot., datë 24.03.2021, me objekt: “Dërgim mostrash për testim”, drejtuar Universitetit Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi këtij Universiteti ekzaminimin/testimin e mostrave Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me

dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës". Bashkëlidhur mostrat për testim, në përputhje me Vendimin Nr. 1826/9 Protokolli, datë 18.03.2021 të Komisionit të Prokurimit Publik. Më datë 25.03.2021 përfaqësuesi Komisionit Prokurimit Publik dërgoi mostrat për testim pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

II.12. Në datën 12.04.2021 është protokolluar pranë Komisionin e Prokurimit Publik me shkresa me nr. 444/3 prot, shkresa e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me nr. 179/1 prot., datë 12.04.2021 me objekt: *"Përgjigje shkresë suaj nr. 1826/7., datë 08.03.2021"*, me përmbajtje si vijon: *"Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1826/7 prot., datë 08.03.2021 "Kërkesë", ju lutem gjeni bashkëngjitur raportet e ekzaminimit të artikujve për uniformën e Gardës së Republikës"*.

II.13. Nëpërmjet shkresës Nr.prot 444/4, datë 29.04.2021, Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Z. G. G, inxhinier pranë Universitetit Politeknik të Tiranë, Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Departamentit të Tekstilit dhe Modës, duke i kërkuar shprehimisht si vijon:

Në vijim të shkresës nr. 179/1 prot, datë 12.04.2021 të protokolluara pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 444/3 prot, datë 12.04.2021 me objekt "Dorëzim përgjigje", ju keni dorëzuar pranë KPP "Raportin e Vlerësimit" në lidhje me përmbushjen e specifikimeve teknike të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë "Arisa Konfeksion" dhe "Malbertex" shpk në procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur, me Nr. REF-78186-11-10-2020, me objekt "Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës", me fond limit 18,000,120 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, (mostrat e operatorëve ekonomikë ju janë dorëzuar sipas procesverbalit të mbajtur në datë 25.03.2021 në mjediset e UPT).

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit (Raport Vlerësimit/Ekzaminimet) të dorëzuar nga ana juaj, duke qenë se kemi të bëjmë me një objekt prokurimi specifik, lind nevoja për sqarimin e disa pyetjeve dhe paqartësive për Komisionin e Prokurimit Publik, për sa i përket disa prej çështjeve të trajtuara në këtë raport/ekzaminim. Sa më sipër, për këtë arsye ju lutemi, të paraqiteni në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, në datë 30.04.2021, ora 10:30.

II.14. Në datën 30.04.2021 ora 10:300, u mbajt seanca dëgjimore në KPP, në prani të ekspertit z. G. G dhe antarëve të Komisionit Prokurimit Publik me përmbajtje si më poshtë vijonë:

Niset seanca dëgjimore në vijim të shkresës nr. 444/4 prot, datë 29.04.2021 “Kërkesë për Asistencë”, në lidhje mbi disa sqarime për “Rraport Ekzaminimi” nr 444/3 prot, datë 12.04.2021 të mbajtur nga eksperti z. G. G, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Në kuadër të hetimit administrativ, mbi pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Gentian Sadiku” P.F në lidhje me mospermbushjen e specifikimeve teknike të mostrave të dorzuara nga operatorët ekonomik “Arisa Konfeksion” sh.p.k, “Malbertex” sh.p.k, për produktet Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, dhe Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës.

Përsa më sipër Komisioni Prokurimit Publik në lidhje me paqartësit e konstatuara në rraport i drejtohet ekspertit z. G. G me pyetje.

Nga përmbajtja e rraportit rezulton se nga ana juaj është përshkruar se jaka për produktin xhup $\frac{3}{4}$ është model korean (drejtkëndor), ndërsa në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi rezulton se jaka është në formë rrethore,

Pyetja: Nga verifikimi i specifikimeve teknike dhe fotos se produktit, a konstatohet se është i njëjti model jake me mostrën fizike. Eksperti përgjigjet se po nga ekzaminimi rezulton se kemi te bejmë me të njëjtin model jake si të mostrës së paraqitur fizikisht ashtu edhe të fotografisë së përshkruar në specifikimet teknike.

Në lidhje me produktin kapele me dekoracionin e strehës për Gradën Gjeneral përsa i përketë dekoracionit të saj, në lidhje me terminologjië e përdorur në rraport ekzaminimi citohet se lartësia dekoracionit në anë 1 cm, e cila vazhdon duke u zgjeruar në qendër 2 cm, në specifikimet teknike nga ana e autoritetit kontraktor është përshkruar se gjërsia e dekoracionit në anë 1 cm, e cila vazhdon duke u zgjeruar në qendër 2 cm. Në kuptim të rraport ekzaminimit a është e njëjta gjë përshkrimi si terminologji nga ana juaj “Lartësi” e dekoracionit me përshkrimin si terminologji nga autoritetit kontraktor “Gjërësi” të dekoracionit. Eksperti z. G. G, përgjigjet po janë e njëjta.

Në lidhje me mostrën e xhupit $\frac{3}{4}$ përsa i përketë materialeve ndihmëse, dhe mënyrës së qepjes së jakës, shpinës dhe mëngët, a janë kryer/qepur këto sipas specifikimeve teknike, Eksperti z. G. G pohon se ashtu sikurse është cituar edhe në rraport ekzaminimi, për këtë mostër është përdorur i njëjti material ndihmës sipas përcaktimeve të bëra në specifikime teknike, gjithashtu edhe mënyra e qepjes së japkës, mëngëve dhe shpinës janë kryer/qepur sipas përshkrimeve në specifikimet teknike, dhe pamja vizuale e mostrës është e njëjtë me atë të përshkruar në spëcifikimet teknike.

Në lidhje me mostrën e xhupit të shkurtër përsa i përketë materialeve ndihmëse, dhe mënyrës së qepjes së jakës, shpinës mëngëve, xhepave të përparëm, pjesës së pasme, bordurave të

poshtme dhe manshetat, a janë kryer/qepur këto sipas specifikimeve teknike, Eksperti z. G. G pohon se ashtu sikurse është cituar edhe në rraport ekzaminimi, për këtë mostër është përdorur i njëjti material ndihmës sipas përcaktimeve të bëra në specifikime teknike, gjithashtu edhe mënyra e qepjes përta i përketë jakës, shpinës mëngëve, xhepave të përparëm, pjesës së pasme, bordurave të poshtme dhe manshetat janë kryer/qepur sipas përshkrimeve në specifikimet teknike, dhe pamja vizuale e mostrës është e njëjtë me atë të përshkruar në specifikimet teknike.

Në këto kushte pas sqarimeve të bëra nga ana e ekspertit z. G. G, në lidhje me paqartësit e hasura në përmbajtjen e rraport ekzaminimit, Komisioni Prokurimit Publik e deklaroi të mbyllur këtë seancë degjimore.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” P.F mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomik “Arisa Konfeksion” ShPK dhe “Malbertex” ShPK me arsyetimin se “Kërkojmë rivlerësim të ofertave duke shqyrtuar mostrat e mallrave të sjella fizikisht (që i cituam më sipër) pranë jush dhe skualifikimin e OE Arisa Konfeksion dhe Malbertex shpk në këtë procedurë prokurimi pasi nuk përmbushin kriteret përcaktuese nga AK. Pranë KVO të Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara ne kemi kërkuar të verifikohen mostrat fizike dhe jo ato të testeve laboratorike duke qenë se problemi është në mostrat fizike të këtyre dy operatorëve pasi nuk janë sipas specifikimeve të kërkuara në DT përkatësisht: 1. Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës. Materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët që nuk janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DT. 2. Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral. Dimensionin dhe dekoracionin i saj nuk përmbush kërkesat e specifikimeve pasi streha duhet të ketë 2 rreshta dekoracion (formë gjethe lisi) sic është përcaktuar në specifikim. Të dy këta OE nuk e kanë paraqitur kapelen sic është e specifikuar në DT. 3. Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës. Materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, xhepat e përparëm, pjesa e pasme, bordurat e poshtme, manshetat që nuk janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DT. (Specifikimet teknike në DT janë të cituara se si duhet të jenë). Lutemi dhe KPP të verifikojë fizikisht mostrat pasi këto dallime verifikohen shumë lehtë edhe me shikim të lirë. Nëse specialistët pranë jush nuk janë të specializuar për të vlerësuar mostrat ashtu sic duhet atherë le të dorëzohen pranë specialistëve të duhur që ndodhen pranë institucionit që ka bërë kërkesën për këto mallra që është Garda e Republikës. Referuar dhe një vendimi të KPP nr. 526/2016 në bazë të ankesës të së cilës kërkohet analizimi i mostrave fizike pasi artikuj të caktuar nuk janë

sipas përmasave të duhura sic kërkohet nga AK ku ankimues është kompania tjetër e jona është një vendim i unifikuar nga ana juaj. Pasi janë bërë vlerësimet e mostrave fizike është konstatuar ky problem.” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mostrat e kërkuara në tabelën e mëposhtme, dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, (fletë-analizë) të lëshuara nga laboratorë, të cilët duhet të jetë të akredituar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë -analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Nr.	Emertimi i Artikullit	Njesia	Kërkesat e Proçedures
1	Kostume uniforme oficeri e nenoficeri (1 kapele per graden Gjeneral , 1 kapele per graden Major Kolonel, 1 kapele per femrat Oficere, 1 kapele per femrat Nenoficere, 1 xhakete, 1 palë pantallona për efektivin oficer e nënoficer, 1 palë pantallona dhe 1 fund për punonjëset oficere e nënoficere)	komplet 1(një)	1(një) "emri i artikullit" 1 (nje) pjesë te lëndës se parë me gjatësi 0,5 ml, dhe gjerësi sa ajo e vet lëndës se parë.
2	Xhup 3/4 me veshje te ngrohtë	copë 1(një)	
3	Xhup i shkurter	copë 1(një)	
4	Bluze pambuku me minge te shkurter	copë 1(një)	
5	Bluza mëngë të shkurta me tre kopsa	copë 1(një)	
6	Këmishë me mëngë të shkurtër	copë 1(një)	

Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: moster “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s’kualifikues.

Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara me adresë: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Tiranë.

III.1.2. Në shtojcën 10 "Specifikimet teknike" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

SPECIFIKIM TEKNIK

Objekti: Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës.

Ky specifikim teknik paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme për prodhimin e artikullit "Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë". Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kërkesat teknike të aksesoreve që shoqerojnë artikullin "Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë" si produkt i gatshëm duke realizuar kompletimin e plotë të tyre. Të gjitha percaktimet teknike të këtij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Lënda e Parë: Pelhure impermeable (tekstil i gomuar) ngjyre e zezë 100 % poliamid.

- **Masa:** 200 gr +/- 8 gr/m²
- **Thurja:** Garniturë.
- **Hollesia e fijeve:** Filament
- **Dëndësia e fijeve në 10 cm:** Në bazë 480 +/- 10 ne ind 330 +/- 10.
- **Qëndrueshmëria në kg:** Në bazë 111 +/- 3 ne ind 74 +/- 3.
- **Qëndrueshmëria e ngjyrës:** Shumë e mirë

Materialet Ndhimëse që duhet të përdorën për ndertimin e artikullit "Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë" janë:

- **Astar** mendafshi me ngjyrë të zezë me perberje 100 % PES
- **Veshje** e ngrohtë vatin e thurur në dy krahët me astar mendafshi ngjyrë e zezë
- **Vatine** me ngjyrë të bardhë me peshë 120 g/m².
- **Zinxhir për mbylljen e xhupit** - Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit, dhëmbët 100% acetal, madhësia e dhëmbëzave 8 VS ose 10VF, shiriti prej tekstili 100% polyester, me ngjyrë të zezë.
- **Zinxhir me fund të hapur, për montimin dhe çmontimin e veshjes së ngrohtë** - Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, për aplikime në linja të harkuara dhe me dy koka, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliester monofilament, shiriti prej tekstili 100% polyester, ngjyra e zezë.
- **Zinxhir për montimin e kapucit** - Standard, me fund të mbyllur, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliester monofilament, shiriti prej tekstili 100% poliester ngjyra e zezë.
- **Flieseline** si material ngjites perforcues special të pershtatshëm për elementet e xhupit me përbërje 100 % PES
- **Kordon** me ngjyrë të zezë methurje gershet me fiksues plastike në fund

- **Astar xhepi** në ngjyrë të erret
- **Butona** metalike mashkull - femer në ngjyrë të zezë .
- **Penj qepje** të zi Nm 80/2 për qepje industriale me përbërje 100 % PES

Elementet Velcro femer (me ngjyrë të zezë) për vendosjen:

- **E shenjës së mbiemrit dhe gradës:** Siper në gjoksin e djathtë e të majtë vendoset velkrof femër 8.5 cm x 2.5 cm, në formë drejtëkendeshi, për vendosjen e mbiemrit dhe gradës.
- **E Stemes së Republikës dhe Stemes së Gardës,** velkrof femer në mëngë, me permasa 7.5 cm x 6 cm +/-0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejtë ndersa e pjesa e poshtme në forme ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës.

Xhupit $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë, kompletohet me:

- **Steme e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Steme Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Shenjë emri** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Grada gjoksi** (sipas specifikimeve të dhëna)

Për vertetësinë e të dhenave teknike të kerkuara në këtë Specifikim Teknik dhe të deklaruara nga subjekti ofertues me anë të mostrave fizike të shoqeruar me Flet-analizen e leshuar nga Laboratori përkatës i tekstil-konfeksioneve, komisioni i vlerësimit të ofertave, ka të drejte që ti verifikojë menjëherë ato. Mos perputhja e treguesve të lëndës së I-rë dhe të materialeve ndihmëse të Specifikimit Teknik me treguesit e lëndës së I-rë dhe të materialeve ndihmëse të përdorura për ndertimin e artikullit “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” të ofruara nga pjesëmarrësi në procedurën e vlerësimit me ato të depozituara në Laboratorin përkatës të tekstil-konfeksioneve përbën dhe konsiderohet kusht skualifikimi për vazhdimin e procedurave.

Qepja:

Jaka e “Xhupit $\frac{3}{4}$ sintetik me veshje të ngrohtë”, është në formë rrethore me lartësi rreth 10 cm. Mbyllja e jakes dhe e xhupit bëhet me zinxhire në sallki dhe 7 butona (2 në pjesën e jakës e 5 në pjesën e trupit), të mbuluar me bordurë. Dy perpareset në pjesën e poshtme kanë nga një xhep të pjerret me dy tegela siper. Në pjesën e gjoksit deri në pjesën e sipërme të xhepave të poshtëm qepen dy xhepa të drejtë me gjërësi 7-7.5 cm, të cilëve u kalohen dy tegela siper. Po kështu në mes të gjatësisë së tyre kalon një tegel.

Në gjoksin e djathtë në qender mbi supanje vendoset velkrof femër në ngjyrë të zezë në formë drejtëkendshi me permasa 8.5 cm x 2.5cm, që do të sherbeje për vendosjen e mbiemrit, ndersa në krahun e majtë në qender mbi supanje vendoset velkrof femër në forme drejtëkendshi me permasa 8.5 cm x 2.5 cm për vendosjen e gradës.

Shpina është dy copeshe me qepje në mes dhe dy tegela. Në pjesën e sipërme të shpines dhe perparseve vendoset supanje e lire e cila qepet në gjithë perimetrin e saj në thellesi 1.5cm nga buza duke krijuar bordurë.

Xhupi, në mëngën e djathtë, 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qendër vendoset me velkrof femer-mashkull “Stema e Gardes” sipas specifikimeve teknike të saj. Po kështu në mëngën e majtë të xhupit 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qendër vendoset me velkrof femer-mashkull “Stema e Republikës” sipas specifikimeve teknike të saj. Në supe ka dy spaleta me gjeresi 5 cm dhe gjatesi deri në bashkimin me jakën. Spalinat përbehen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme të cilave për forcim iu vendoset ekstrafor (flieseline). Spalines 5 mm larg buzëve i kalohet një tegel dysh zbukurimi. Montimi i spalinave në supe duhet të bëhet në mënyrë të tillë që mesi i spalines të perputhet me tegelin e bashkimit të shpines me gjoksin.

Mëngët janë një copeshe, në qepjen e saj dhe 3 - 4 cm nga fundi i menges qepet një spaline me gjeresi 5 cm për ngushtimin e mëngës e cila mberthehet me 2 butona mashkull-femer ngjyrë të zezë.

Përparësja e majtë ka një xhep me fileto me ylyk dhe kopse të vogël të zezë. Gjithë pjesa e brendëshme e xhupit përparëset, shpina, mëngët janë të veshura me astar mendafshi ngjyrë e zezë me vatin 150-180 gr/m² e nderthurur në formë rombi. Në mes të belit në të dy anët në bashkimet e perparseve me shpinen qepet nga një ylyk 4.5 – 5 cm për kalimin e rripit i cili qepet prej të njëjtit material si xhupi. Rripi është me togez ngjyrë të zezë, i gjere 4 +/- 0.2 cm e gjatesi 160 – 170 cm përshkohet nga dy tegela në të dy anet.

Veshja e ngrohtë e brendëshme, është vatin e thurur në dy krahët, me astar ngjyre të zezë, përbëhet nga pjesa e shpines dhe e gjokseve. Veshja e ngrohtë duhet të jetë e vendosur në të gjithë sipërfaqen e brendëshme të shpines dhe të gjokseve. Sipërfaqja e veshjes së ngrohtë duhet të perputhet me sipërfaqen e shpines dhe të gjokseve. Fiksimi i veshjes së ngrohtë me trupin e xhupit duhet të bëhet me ane të zinxhirit që fiksohet nga brenda përgjatë gjithë gjatësisë së mostres gjoksit të majtë duke vazhduar lart në pjesën e qafës dhe me pas zbrit poshtë deri në fund nga brenda përgjate gjithë gjatësië së mostres të gjoksit të djathtë. Gjatësia e veshjes së ngrohtë duhet të jetë 8-10 cm me e vogël se gjatësia e shpines dhe e gjokseve të xhupit.

Xhupi kompletëhet me **kapuç** prej të njëjtit material si i xhupit, i cili montohet me zinxir konfeksioni në bashkimin e jakës me trupin. Kapuçi në pjesën fundore në brendësi, përgjatë gjithë gjatësië përshkohet nga një kordon me ngjyrë të zezë me thurje gershet me fiksues plastikë në fund, për mbylljen e kapuçit sipas nevojës.

“Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” duhet të jetë simetrik në të gjithë elementet përbërës të tij.
“Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” është i njëjte në model si për meshkuj ashtu dhe për femra.

Tegelat e qepjes duhet të jenë të forta, uniforme, të mos kenë vende të shqepura, të jenë simetrike, të rregullt dhe të drejta. Buzet e tegelave të brendshme të detajeve përberëse të

xhupit duhet te behen me syzator qe te mos krijojne dhe lejojne daljen e fijeve. Mbylljet e xhupit duhet te realizohen me syzator. Tegelat duhet jene të fortë në menyrë të tillë që të mos hapen nën ushtrimin e forces së duarve.

Xhupat te jene numrave 44 – 56.

Sasia sipas numerave do bëhet mbi bazën e kerkesave të Gardës me lidhjen e kontratës me prodhuesin. Permasat e “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” si produkt i gatshem (cm) jepen në këtë tabelë :

Gjatesia e trupit	Prerja	Iniciali prerjes	Gjatesia e xhupit produkt i gatshem
155-160	e pare	I	82
161-166	e dyte	II	84
167-172	e trete	III	88
173-178	e katert	IV	92
179-184	e peste	V	96
185-190	e gjashte	VI	100

Xhupat te prodhohen me prerjet sipas sasive ne tabelen e meposhteme:

Etiketimi, Amballazhimi:

Xhupave u vendoset nga një etikete (në pjesën e brëndeshme të tyre në qender të shpines ku bashkohet trupi me jaken) e cila duhet të permbaje numrin e gjoksit dhe prerjen si dhe shenjat konvencionale te trajtimit në larje etj. Xhupat amballazhohen sejcili në qese polietileni futen në kuti kartoni deri në 20 cope secila. Kutite paisen me etiketa ku të shenohet artikulli, emri i prodhuesit, data, numri gjoksit. Në çdo kuti futen xhupa të një numri.

Transportimi: Transportimi do të bëhet me mjete të pershtateshme për tu mbrojtur nga agjentet atmosferik.

Afati i lëvrimit: Për çdo vit kalendarik brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.

SPECIFIKIM TEKNIK

Objekti: “Xhup i shkurtër” për punonjësit e Gardës të Republikës.

Ky specifikim teknik paraqet kerkesat themelore teknike të domosdoshme të artikullit “Xhup i shkurtër”. Në këtë specifikim teknik përcaktohen gjithashtu dhe kerkesat teknike të aksesoreve që shoqërojnë artikullin “Xhup i shkurtër” si produkt i gatshem duke realizuar kompletimin e plotë të tyre.

Të gjitha percaktimet teknike të ketij specifikimi teknik duhen të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Lënda e Parë: Tekstil i përforcuar ngjyre e zezë 100 % poliester .

Masa: 240 - 260 gr/m²

Shtresa e jashtme Tekstil i endur
- Thurja: Garniturë (1:1)
- Përbërja: 100 % poliester
- Ngjyra: E zezë
- Qëndrueshmeria e ngjyrës: Shumë e mirë

Shtresa e brëndshme: Frazelinë termoadezive
- Thurja: Trikot
- Përbërja: 100 % poliester
- Ngjyra: E zezë

Materialet Ndhmëse që duhet të përdorën për ndertimin e artikullit “Xhup i shkurtër” janë:

Astari me mbushje me filtër për trupin dhe mëngët e xhupit që përbëhet nga:

Shtresa e jashtme - me perberje 100% poliester,thurje diagonale, pesha 250 gr/m² me ngjyrë të zezë.

Mbushja - 100% fibra poliester

Shtresa e brëndshme - me përbërje 100% poliester, e trikotuar dhe e dërstiluar , pesha 90 gr/m² me ngjyrë e zezë.

Astar në formë rrjete për trupin - me përbërje 90% polyester e 10% spandex , pesha 90 gr/m² me ngjyrë e zezë.

Astar për mëngët dhe xhepat me përbërje 50% pambuk e 50% poliester,thurje diagonale, pesha 80 gr/m² me ngjyrë e zezë.

Përforcues - Frazelinë termoadezive me ngjyrë të errët për jakën, kapakët e xhepave, kapakët e mëngëve, bordurën e poshtme të xhupit dhe spaletat.

Llastik i gjerë për pjesën e poshtme të xhupit- Përbërja 100 % poliester, ngjyra e zezë, gjerësia 4 cm.

Shirit për termosaldimin e disa qepjeve të xhupit.

Filli - 100% polyester, ngjyra e njëjte me xhupin.

Perçinat (buton metalik) - 7 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë, me ngjyrë të zezë.

Zinxhir për mbylljen e xhupit - Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit, dhëmbët 100% acetal, madhësia e dhëmbëzave 8 VS ose 10VF, shiriti prej tekstili 100% polyester, me ngjyrë të zezë.

Zinxhir me fund të hapur, për montimin dhe ëmontimin e astarit me mbushje - Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, për aplikime në linja të harkuara dhe me dy koka, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliester monofilament, shiriti prej tekstili 100% polyester, ngjyra e zezë.

Zinxhir për xhepat e brendshëm të xhupit - Standard, me fund të mbyllur, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliestër monofilament, shiriti prej tekstili 100% poliestër ngjyra e zezë.

Elementet Velcro femer (ngjyre e zeze) për vendosjen:

- **E shenjes së mbiemrit dhe gradës:** Siper në gjoksin e djathtë 8.5 cm x 2.5 cm, vendoset velkrof femer në formë drejtëkëndeshi për vendosjen e mbiemrit.
- **E Stemes së Republikës dhe Stemes së Gardës,** velkrof femer në mënyrë, me permasa 7.5 cm x 6 cm +/-0.1 cm, pjesa e sipërme është e drejtë ndërsa e pjesa e poshtme në formë ovale (shqyti) me distancë rreth 7-8 cm nga gavatura e mëngës

Xhupi i shkurtër, kompletohet me:

- **Stemë e Republikës** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Stemë Garde** me velkrof mashkull (sipas specifikimeve të dhëna)
- **Grada të ndryshme supi** në formë spaleti (sipas specifikimeve të dhëna)

Për vërtetësinë e të dhënave teknike të kërkuara në këtë Specifikim Teknik dhe të deklaruara nga subjekti ofertues me anë të mostrave fizike të shoqëruar me Flet-analizen e leshuar nga Laboratori përkatës i tekstil-konfeksioneve, komisioni i vlerësimit të ofertave, ka të drejtë që të verifikojë menjëherë ato. Mos perputhja e treguesve të lëndës së I-rë dhe të materialeve ndihmëse të Specifikimit Teknik me treguesit e lëndës së I-rë dhe të materialeve ndihmëse të përdorura për ndertimin e artikullit “Xhup i shkurtër” të ofruara nga pjesëmarrësi në procedurën e vlerësimit me ato të depozituara në Laboratorin përkatës të tekstil-konfeksioneve përbën dhe konsiderohet kusht skualifikimi për vazhdimin e procedurave.

Qepja:

Jaka e “Xhupit shkurtër”, është në formë rrethore me lartësi 5 cm. Mbyllja e jakës bëhet me gjuhez me dy perëina metalike.

Pjesët e Përparme:

Mbyllja e xhupit duhet të bëhet me anë të zinxhirit. Zinxhiri duhet të jetë i mbuluar me bordurë me gjerësi rreth 5 cm, për tu mbrojtur nga era. Bordura duhet të mbyllet me anë të 7 perçinave metalike. Buzët e bordurës (tek mbyllja) duhet të përshkohen nga një tegel linear vertikal sipërfaqësor një gjilpërësh.

Xhepat e Përparmë:

Xhupi në pjesën e përparme ka dy xhepa të jashtëme me kapak, që mbyllen me perçine metalike dhe dy xhepa të brendshëm. Hapja e xhepit duhet të jetë 18 cm e gjerë.

Pjesët e Pasme:

Mbrapa xhupi duhet të përbëhet nga dy pjesë të qepura me njëra tjetrën me tegel linear një gjilpërësh: pjesa e shpatullave dhe pjesa e shpinës.

Në distancë 1 mm mbi tegelin qepës duhet qepur një tjetër tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Bordurat e Poshtme

Në pjesën e poshtme xhupi duhet të përfundojë me një bordurë rreth 4 cm të lartë. Bordura duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive. Tek dy pjesët anësore (në të majtë dhe në të djathtë), bordura duhet të jetë e pajisur me llastik.

Mëngët:

Mëngët duhet të ndërtohen me dy pjesë gjatësore, të cilat duhet të qepen me njëra-tjetrën me tegela linearë një gjilpërësh: një tegel gjatësor tek aksi vertikal i sqetullës dhe një tegel gjatësor tek aksi vertikal i bërrylit.

Tegeli tek aksi i bërrylit duhet të lidhet me tegelin e pjesëve të pasme të xhupit, në mënyrë që të formohet një linjë e vetme dekorative.

Në distancë 1 mm mbi tegelin qepës duhet qepur një tjetër tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Manshetat. Në fund mëngët duhet të mbyllen me mansheta në formë bordure me lartësi rreth 4 cm. Manshetat duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive.

Kapakët duhet të pajisen me gjuhëz me elementëve Velcro për të shtrënguar mëngën. Buzët e lira të manshetave duhet të përshkohen nga një tegel perimetral linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Astari:

Xhupi duhet të vishet tek pjesa e trupit me astar në formë rrjete dhe tek mëngët me astar prej tekstili. Astari duhet të qepet tek paramontura.

Astari i lëvizshëm:

Xhupi (me gjithë mëngët) duhet të pajiset me astar të lëvizshëm me mbushje për mot të ftohtë.

Astari i lëvizshëm duhet të përbëhet nga tre shtresa: shtresa e jashtme prej tekstili methurje diagonale, mbushja me fibra poliestre dhe shtresa e brendshme (në kontakt me trupin) prej tekstili të trikotuar dhe dërstiluar.

Përveç qepjes perimetrale, shtresat duhet të qepen me njëra tjetrën edhe me anë të tegelave linearë një gjilpërësh që krijojnë motive me rombe në të gjithë sipërfaqen.

Përmasat e rombeve duhet të jenë përafërsisht 5 x 5 cm.

Astari duhet të montohet me anë të një zinxhiri të vetëm, të hollë e të përshtatshëm për linjat e harkuara. Zinxhiri duhet të ketë dy koka dhe duhet të hapet nga të dyja anët. Ai duhet të qepet tek paramontura e astarit në formë rrjete. Zinxhiri duhet të jetë i butë dhe të mos ndjehet gjatë veshjes.

Xhepat e brendshëm. Xhupi duhet të pajiset me dy xhepa të brendshëm me zinxhir 17 cm të gjatë, një xhep në të majtë dhe një në të djathtë. Filetot e xhepave duhet të jenë me tekstil të njëjtë si xhupi. Xhepat e brendshëm duhet të qepen tek astari prej rrjete. Astari i xhepave të brendshëm duhet të jetë i njëjtë me astarin e mëngëve. Përmasat e astarit duhet të jenë 18 x 23 cm.

Në supe në vend të spaletave vendosen dy ylyqe për montimin e gradave të supit në formë spalete. Ylyqet me permasa 4 x 1 cm qepën në menyrë të tillë që mesi i ylykut të jetë mbi tengelin e bashkimit të shpines me gjoksin. Ylyku i parë qepet 2 cm nga tengeli i rrethit të mëngës (gavatura). Ylyku i dytë qepet 6 cm nga ylyku i parë.

Xhupat të jenë numrave 46-56.

Sasia sipas numerave do bëhet mbi bazën e kërkesave të Gardës me lidhjen e kontratës.

Etiketimi, Amballazhimi:

Xhupave u vendoset nga një etiketë (në pjesën e brendeshme) e cila duhet të përmbajë numrin e gjoksit dhe prerjen, si dhe shenjat konvencionale të trajtimit në larje etj.

Xhupat amballazhohen sejcili në qese polietileni futën në kuti kartoni. Kutite paisen me etiketa ku të shenohet artikulli, emri i prodhuesit, data, numri gjoksit. Në çdo kuti futen xhupa të një numri.

Transportimi: Transportimi do të bëhet me mjete të përshtatshme për tu mbrojtur nga agjentet atmosferik.

Afati i lëvrimit: Për çdo vit kalendarik brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.

KAPELJA :



Per graden Gjeneral



Per gradat Majot-Kolonel

Per procesin e pergatitjes dhe qepjes se kapeles se kostumit nevojiten makina speciale qepjeje dhe puntore te specializuar sidomos per procesin e montimit dhe qepjen e strehes se kapeles. Materialet te cilat duhen te perdoren per ndertimin e kapeles jane:

- **Stof** i njejte me ate te xhaketes e te pantallonit.
- **tel petashuq** shirit çeliku me gjeresi **2 - 3.5 mm** qe vendoset ne brendesi rreth e qark tepelekut
- **shirit plastik** i presuar me vrima per ajrim me gjeresi **5.5 cm** dhe trashesi **1-2 mm** per forcim si
- **fortese** rreth e qark qemerit
- **shirit** i zi i **4.5–5.5 cm** i gjere, material ingeliti me vrima per ajrim qe vendoset rreth e qark qemerit
- **astar** i zi i birosur per ajrim qe vendoset brenda kapeles,poshte tepelekut
- **Material** plastik i pathysem, per fortese ku do te vendoset emblema
- **strehe** e zeze me lluster me dekoracionin perkates(gjethe lisi) e perforcuar ne brendesi me karton prespan te presuar ose flete PVC e presuar me trashesi **1.5 – 2 mm**

Permasat kryesore te kapeles jepen ne tabelen e meposhteme (ne cm) :

A – lartesia e rrethit te kapeles sipas perimetrit te kokes

B – gjeresia e urave perpara

C – gjeresia e urave mbrapa

D – gjatesia ne qender e tepelekut te kapeles

E – gjeresia ne qender e tepelekut te kapeles

F – gjatesia e shiritit petashuq te celikut qe vendoset perreth tepelekut te kapeles

Nr. kapeles	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	tol. +/- cm
Permasa											
A	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	0.1
B	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7	0.1
C	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	4.5	0.1
D	26.5	26.5	27.5	27.5	28	28	28.5	28.5	29	29	0.3
E	25.5	25.5	26	26	27	27	28	28	28.5	28.5	0.3
F	74	75	76	77.5	79	81	83	85	87	89	0.5

Kapelet e meshkujve do jenë të numrave nga 54-59 ne sasite e meposhtme.

Nr	54	55	56	57	58	59	Shuma
%	10	30	46	34	20	10	150

Kapelet me dekoracionin e strehes per graden Gjeneral, 1 cope me numer 57, dhe 1cope me numer 58

- Kapelet e tjera me dekoracionin e strehes per gradat Major-Kolonel

- Kapelet e femrave do jene te numrave nga 54- 57 ne sasite e meposhtme.

Kapelet e femrave do jene te numrave nga 54- 57 ne sasite e meposhtme.

Nr	54	55	56	57	Shuma
sasia	2	4	2	2	10

- Kapelet me dekoracionin e strehes per oficeret, 2 cope me numer 55
- Kapelet e tjera streha pa dekoracion

Kapelja perbehet ne vetevete nga tepeleku, kater urat dhe qemeret. Brenda kapeles nga poshte siperfaqes se stofit te tepeleku vendoset i shtrire mire, astar me vrime (material special) qe ka si veti kryesore lejimin e depertueshmerise se ajrit dhe avujve te kokes te perdoruesit. Per graden madhore - Gjeneral streha plastike ne pjesen e perparme ne gjithe gjatesine e saj ka te qendisur dy shirit ne forme gjethe lisi e punuar me fije me ngjyre ari. Dekoracioni kurore mbeshetet ne te gjithe gjeresine e strehes se kapeles. Gjeresia e e dekoracionit ne ane 1cm, duke u zgjeruar ne qender 2 cm. Ndersa per gradat e larta (Major-Kolonel) nje shirit ne forme gjethe lisi e punuar me fije, ngjyre ari. Kapelja ne bashkimin e tepeleku me rrethin, pershkohet nga nje shirit i kuq 3 mm. Filetoja e tekstit vendoset e shtrire mire ne menyre te dukshme siper tek tepeleku pergjate gjithe perimetrit te tij dhe ne te dy buzet siper dhe poshte perreth te gjithe perimetrit te qemerit. Urat perpara dhe mbrapa duhet te jene te perforcuara me fortese te kollaritur. Streha e kapeles te jete me gjeresi ne pjesen e qendres se harkut te saj 56-57 mm, dhe trashesi 2.5-3.5 mm, ne brendesi eshte e perforcuar me karton prespan te presuar ose i flete PVC e presuar me trashesi 1.5 – 2 mm. Ne pjesen e siperme streha mbulohet me nje flete PVC-je ne ngjyre te zeze te lemuar dhe te shkelqyeshme. Pjesa e perparme e strehes perfundon me nje bordure plastike te perthyer dy here e cila fiksohet me tegel siper dhe poshte deri ne ekstreme. Streha ka forme gjysem hene ku harku i brendshem duhet te jete me rreze 230-240 mm nga e cila del masa 205 mm. Pjesa e perparme ne forme kurbe ne qender te strehes duhet te kete gjeresi 56-57 mm duke iu afruar te dy ekstremeve deri ne piken zero me harkun e pare.

Dekoracioni i strehes se kapeles



Per graden gjeneral, per gradat Major - Kolonel me nje shirit pa shiritin e brendshem,

1. Pershkrimi

Element baze jane dekoracioni kuror gjethe lisi ne forme harkore sipas strehes se kapeles. Te gjitha elementet e dekoracionit te kapeles jane qendisura me fije ngjyre ari. Dekoracioni kurore mbeshetet ne te gjithe gjeresine e strehes se kapeles.

2. Materiali

Tekstil i holle i qendisur me fill me ngjyre ari.

3. Ngjyrat

Ngjyra e arte. Qendrueshmeria e ngjyres te jete e larte.

4. Dimensionet

Gjeresia e nje dekoracionit ne ane eshte 1cm, duke u zgjeruar ne qender 2 cm. Per graden Gjeneral streha ka dy elemente te tille kurore, te cilat vendosen te ngjitura njera prane tjetres duke mbuluar gjithe strehen e kapeles, ndersa per gradat Major- Kolonel, streha ka nje element te tille kurore.

Etiketimi, Amballazhimi

Kostumit (kapeles, xhaketes e pantallonit) ne pjesen e brendeshme te tyre u vendoset nga nje etikete e cila duhet te permbaje : nr. i gjoksit, prerjen dhe shenjat konvencionale te trajtimit te stofit ne larje hekurosje, nr. kapeles etj. Te xhaketa etiketa qepet ne pjesen e brendshme te jakes ne qender te saj ku bashkohet me shpinen, te pantalloni ne pjesen e brendshme ku bashkohet qemerit me perpareshen, te kapelja ne pjesen e brendshme te tepeleikut.

Kostumi kompletohet xhakete dhe dy pale pantallona , vendoset ne varse rrobash(kremastar) dhe futet ne qese transparente plasmasi.

Afati i lëvrimit: *Për çdo vit kalendarik brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.5. Në nenin 23, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit

duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin. “

III.1.6. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon se, autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e

vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.1.10. KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “*Gentian Sadiku*” P.F ka të bëjë përkatësisht me pretendime për mos përmbushjen e specifikimeve teknike nga ana e operatorëve ekonomikë “*Arisa Konfeksion*” shpk dhe “*Malbertex*” shpk pjesëmarrës në procedurën e prokurimit në lidhje me kriterit për paraqitjen e mostrave konkretisht për mostrat e produkteve *Xhup ¾ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës*, të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Në kuadër të shqyrtimit administrative të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se për sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posaçme teknike dhe kryerja e veprimeve procedurale për realizimin e analizave/ekzaminimeve të gjendjes fiziko – mekanike/ dhe vizual të mostrave të dorëzuara në kuadër të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Nga verifikimi i listës së ekspertëve dhe laboratorëve të akredituara të miratuar nga Komisioni i Prokurimit Publik për vitin 2021 nuk rezulton asnjë laborator, apo ekspert të miratuar për kryerjen e verifikimeve. Për këtë arsye sikundër u citua edhe më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, me përfaqësuesit e palëve të operatorit ekonomik ankimues (në mungesë), përfaqësuesit e operatorëve ekonomikë “*Arisa Konfeksion*” shpk, “*Malbertex*” shpk dhe autoritetit kontraktor, zhvilluan një seancë dëgjimore pranë ambjenteve të Komisionit ku të pranishëm ishin përfaqësues të operatorëve ekonomikë “*Arisa Konfeksion*” shpk, “*Malbertex*” shpk dhe autoritetit kontraktor “*Agjencia e Blerjeve të Përqendruara*”. Në seancë dëgjimore pas diskutimeve të shumta u dakortësua edhe me konsensusin e palëve pjesëmarrëse që Komisioni i Prokurimit Publik ti drejtohej Universitetit Politeknik të Tiranës si organ i specializuar për të dhënë asistencën e nevojshme nëpërmjetë ekspertëve të tij për ekzaminimin e mostrave të kontestuara. Kështu, KPP, kërkoi nga ky institucion që ti vihet në dispozicion një ekspertë për ekzaminimin e mostrave *Xhup ¾ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës* të paraqitura nga operatorët ekonomikë “*Arisa Konfeksion*” shpk dhe “*Malbertex*” shpk nëse ato janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit

III.1.11. Pas konfirmimit të Universitetit Politeknik të Tiranës për disponimin nga ana e tyre të eksperti z. G. G, inxhinier pranë Departamentit Tekstil dhe Modë, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin 1826/7 prot datë 18.03.2021 vendosi:

1. Të urdhëroj kryerjen e ekspertizës për ekazminimin, analizimin fiziko mekanike për mostrat Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk, nga laborator i akredituar i Universitetit Politeknik të Tiranës, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur, me Nr. REF-78186-11-10-2020, me objekt “Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës”, me fond limit 18,000,120 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Të ekzaminohen, testohen mostrat Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, dhe Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës.
 - Per zerin Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës, të ekzaminohet mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, për të cilat operatori ekonomik ankimes pretendon se nuk janë qepur sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit, nga operatorët “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk.
 - Per zerin Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral, të ekzaminohet dimensionin dhe dekoracionin i kapeles pasi nuk përmbushin specifikimet teknike, pasi streha duhet të ketë 2 rreshta dekoracion në (formë gjethe lisi), siç është përcaktuar në specifikimet teknike të dokumentave standarte të tenderit, nga operatorët “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk.
 - Per zerin Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës, të ekzaminohen materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, xhepat e përparëm, pjesa e pasme, bordurat e poshtme si dhe manshetat, pasi nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit, nga operatorët “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk.
3. Operatori ekonomik “Gentian Sadiku” P.F, të parapaguajë për llogari të Universitetit Politeknik të Tiranës, shumën e përcaktuar nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës nëpërmjet shkresës nr. 409/3 prot datë 11.03.2021 protokolluar me tonën me shkresën nr. 1826/8 prot, datë 16.03.2021, për 15 zëra shërbimi në shumën prej 15.000 lekë pa tvsh në total për testimin e mostrave të dorëzuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 23.03.2021 ora 12:00.
4. Në datën 23.03.2021 ora 12:00 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara dhe të operatorëve ekonomikë “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk me autorizim të posaçëm të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

5. Të njoftojë laboratorin e Universitetit Politeknik të Tiranës për kryerjen e testimit të mostrave në datën dhe orën e përcaktuar.
6. Bashkangjitur vendimit do të gjënden edhe një kopje e specifikimeve teknik të procedurës së prokurimit objekt ankimi për mostrat e kontestuara.

III.1.12. Me shkresën nr.179/1 prot datë 12.04.2021 me lëndë “Përgjigje shkresës suaj Nr. 1826/7 Prot., datë 08.03.2021”, Universiteti Politeknik i Tiranës Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik Raportet e Ekzaminimit të artikujve për uniformën e Gardës së Republikës si më sipër cituar.

III.1.13. Komisioni i Prokurimit Publik referuar sa më sipër, si dhe pretendimeve të ngritura në ankesë nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PF, në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, ku mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomikë “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk konkretisht 1. Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës. Materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët që nuk janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DT. 2. Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral. Dimensioni dhe dekoracioni i saj nuk përmbush kërkesat e specifikimeve pasi streha duhet të ketë 2 rreshta dekoracion (formë gjethe lisi) siç është përcaktuar në specifikim. 3. Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës. Materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, xhepat e përparëm, pjesa e pasme, bordurat e poshtme, manshetat që nuk janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DT, vëren se në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se për Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës. materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët janë:

Materialet Ndihmëse që duhet të përdorën për ndertimin e artikullit “Xhup $\frac{3}{4}$ me veshje të ngrohtë” janë:

- **Astar** mendafshi me ngjyrë të zezë me perberje 100 % PES
- **Veshje** e ngrohtë vatin e thurur në dy krahet me astar mendafshi ngjyrë e zezë
- **Vatine** me ngjyrë të bardhë me peshë 120 g/m².
- **Zinxhir për mbylljen e xhupit** - Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit, dhëmbët 100% acetal, madhësia e dhëmbëzave 8 VS ose 10VF, shiriti prej tekstili 100% polyester, me ngjyrë të zezë.
- **Zinxhir me fund të hapur, për montimin dhe çmontimin e veshjes** se ngrohte - Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, për aplikime në linja të harkuara dhe me dy koka, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliestër monofilament, shiriti prej tekstili 100% polyester, ngjyra e zezë.
- **Zinxhir** për montimin e kapucit - Standard, me fund të mbyllur, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliestër monofilament, shiriti prej tekstili 100% poliestër ngjyra e zezë.
- **Flieseline** si material ngjites perforcues special të pershtatshem për elementet e xhupit me përbërje 100 % PES
- **Kordon** me ngjyrë të zezë me thurje gershet me fiksuese plastike në fund

- **Astar xhepi** në ngjyrë të erret
- **Butona** metalike mashkull - femer në ngjyrë të zezë .
- **Penj qepje** të zi Nm 80/2 për qepje industriale me përbërje 100 % PES

Jaka e “Xhupit $\frac{3}{4}$ sintetik me veshje të ngrohtë”, është në formë rrethore me lartësi rreth 10 cm. Mbyllja e jakes dhe e xhupit bëhet me zinxhire në sallki dhe 7 butona (2 në pjesën e jakës e 5 në pjesën e trupit), të mbuluar me bordurë. Dy perparse në pjesën e poshtme kanë nga një xhep të pjerret me dy tegela sipër. Në pjesën e gjoksit deri në pjesën e sipërme të xhepave të poshtëm qepen dy xhepa të drejtë me gjërësi 7-7.5 cm, të cilëve u kalohen dy tegela sipër. Po kështu në mes të gjatësisë së tyre kalon një tegel.

Në gjoksin e djathtë në qender mbi supanje vendoset velkrof femër në ngjyrë të zezë në formë drejtekendshi me permasa 8.5 cm x 2.5cm, që do të sherbeje për vendosjen e mbiemrit, ndërsa në krahun e majtë në qender mbi supanje vendoset velkrof femër në formë drejtekendshi me permasa 8.5 cm x 2.5 cm për vendosjen e gradës.

Shpina është dy copeshe me qepje në mes dhe dy tegela. Në pjesën e sipërme të shpines dhe perparseve vendoset supanje e lire e cila qepet në gjithë perimetrin e saj në thellesi 1.5cm nga buza duke krijuar bordurë.

Xhupi, në mëngën e djathtë, 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qendër vendoset me velkrof femër-mashkull “Stema e Gardes” sipas specifikimeve teknike të saj. Po kështu në mëngën e majtë të xhupit 7-8 cm poshtë qepjes së bashkimit të mëngës me trupin e matur nga pika me e lartë e supit në qendër vendoset me velkrof femër-mashkull “Stema e Republikës” sipas specifikimeve teknike të saj. Në supë ka dy spaleta me gjërësi 5 cm dhe gjatësi deri në bashkimin me jakën. Spalinat përbehen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme të cilave për forcim iu vendoset ekstrafor (flieseline). Spalines 5 mm larg buzëve i kalohet një tegel dysh zbkurimi. Montimi i spalinave në supë duhet të bëhet në mënyrë të tillë që mesi i spalines të perputhet me tegelin e bashkimit të shpines me gjoksin.

Mëngët janë një copeshe, në qepjen e saj dhe 3 - 4 cm nga fundi i menges qepet një spaline me gjërësi 5 cm për ngushtimin e mëngës e cila mberthehet me 2 butona mashkull-femer ngjyrë të zezë.

Përparseja e majtë ka një xhep me fileto me ylyk dhe kopse të vogël të zezë. Gjithë pjesa e brendëshme e xhupit perparse, shpina, mëngët janë të veshura me astar mendafshi ngjyrë të zezë me vatin 150-180 gr/m² e nderthurur në formë rombi. Në mes të belit në të dy anët në bashkimet e perparseve me shpinën qepet nga një ylyk 4.5 – 5 cm për kalimin e rripit i cili qepet prej të njëjtit material si xhupi. Rripi është me togez ngjyrë të zezë, i gjere 4 +/- 0.2 cm e gjatësi 160 – 170 cm përshkohet nga dy tegela në të dy anet.

Për Kapele me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral. DimENSIONI dhe dekoracioni i në specifikimet teknike janë si më poshtë:

Për gradën gjeneral, për gradat Major - Kolonel me një shirit pa shiritin e brenshëm,

1. Përshkrimi

Element baze janë dekoracioni kuror gjethe lisi ne forme harkore sipas strehes se kapeles. Te gjitha elementet e dekoracionit te kapeles jane qendisura me fije ngjyre ari. Dekoracioni kurore mbeshetet ne te gjithë gjerësinë e strehes se kapeles.

2. Materiali

Tekstil i holle i qendisur me fill me ngjyre ari.

3. Ngjyrat

Ngjyra e arte. Qendrueshmeria e ngjyres te jete e larte.

4. Dimensionet

Gjerësia e nje dekoracionit ne ane eshte 1cm, duke u zgjeruar ne qender 2 cm. Per graden Gjeneral streha ka dy elemente te tille kurore, te cilat vendosen te ngjitura njera prane tjetres duke mbuluar gjithë strehen e kapeles, ndersa per gradat Major- Kolonel, streha ka nje element te tille kurore.

Për Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës, materialet ndihmëse, mënyra e qepjes për jakën, shpinën, mëngët, xhepat e përparëm, pjesa e pasme, bordurat e poshtme, manshetat sipas specifikimeve teknike janë si më poshtë:

Materialet Ndihmëse që duhet të përdorën për ndertimin e artikullit “Xhup i shkurtër” janë:

Astari me mbushje me filtër për trupin dhe mëngët e xhupit që përbëhet nga:

Shtresa e jashtme - me perberje 100% poliester,thurje diagonale, pesha 250 gr/m2 me ngjyrë të zezë.

Mbushja - 100% fibra poliester

Shtresa e brëndshme - me përbërje 100% poliester, e trikotuar dhe e dërstiluar , pesha 90 gr/m2 me ngjyrë e zezë.

Astar në formë rrjete për trupin - me përbërje 90% polyester e 10% spandex , pesha 90 gr/m2 me ngjyrë e zezë.

Astar për mëngët dhe xhepat me përbërje 50% pambuk e 50% poliester,thurje diagonale, pesha 80 gr/m2 me ngjyrë e zezë.

Përforcues - Frazelinë termoadezive me ngjyrë të errët për jakën, kapakët e xhepave, kapakët e mëngëve, bordurën e poshtme të xhupit dhe spaletat.

Llastik i gjerë për pjesën e poshtme të xhupit- Përbërja 100 % poliester, ngjyra e zezë, gjerësia 4 cm.

Shirit për termosaldimin e disa qepjeve të xhupit.

Filli - 100% polyester, ngjyra e njëjte me xhupin.

Perçinat (buton metalik) - 7 copë Nr. 27 (d 17 mm) + 1 rezervë, me ngjyrë të zezë.

Zinxhir për mbylljen e xhupit - Standard, me fund të hapur, me rezistencë maksimale ndaj ujit, dhëmbët 100% acetal, madhësia e dhëmbëzave 8 VS ose 10VF, shiriti prej tekstili 100% polyester, me ngjyrë të zezë.

Zinxhir me fund të hapur, për montimin dhe ëmontimin e astarit me mbushje - Standard, me dhëmbë spirale, me fund të hapur, për aplikime në linja të harkuara dhe me dy koka,

madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliestër monofilament, shiriti prej tekstili 100% polyester, ngjyra e zezë.

Zinxhir për xhepat e brendshëm të xhupit - Standard, me fund të mbyllur, madhësia e dhëmbëzave 4 CF ose 5 CF, dhëmbët 100% poliestër monofilament, shiriti prej tekstili 100% poliestër ngjyra e zezë.

Jaka e “Xhupit shkurtër”, është në formë rrethore me lartësi 5 cm. Mbyllja e jakës bëhet me gjuhez me dy perëina metalike.

Mëngët duhet të ndërtohen me dy pjesë gjatësore, të cilat duhet të qepen me njëra-tjetrën me tegela lineare një gjilpërësh: një tegel gjatësor tek aksi vertikal i sqetullës dhe një tegel gjatësor tek aksi vertikal i bërrylit.

Tegeli tek aksi i bërrylit duhet të lidhet me tegelin e pjesëve të pasme të xhupit, në mënyrë që të formohet një linjë e vetme dekorative.

Në distancë 1 mm mbi tegelin qepës duhet qepur një tjetër tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Pjesët e Pasma:

Mbrapa xhupi duhet të përbëhet nga dy pjesë të qepura me njëra tjetrën me tegel linear një gjilpërësh: pjesa e shpatullave dhe pjesa e shpinës.

Në distancë 1 mm mbi tegelin qepës duhet qepur një tjetër tegel linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Xhepat e Përparmë:

Xhupi në pjesën e përparme ka dy xhepa të jashtem me kapak, që mbyllen me perçine metalike dhe dy xhepa të brendshëm. Hapja e xhepit duhet të jetë 18 cm e gjerë.

Bordurat e Poshtme

Në pjesën e poshtme xhupi duhet të përfundojë me një bordurë rreth 4 cm të lartë. Bordura duhet të përbëhet nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive. Tek dy pjesët anësore (në të majtë dhe në të djathtë), bordura duhet të jetë e pajisur me llastik.

Manshetat. Në fund mëngët duhet të mbyllen me mansheta në formë bordure me lartësi rreth 4 cm. Manshetat duhet të përbëhen nga dy shtresa tekstili të njëjtë (si xhupi) të përforcuara nga brenda me frazelinë termoadezive.

Kapakët duhet të pajisen me gjuhez me elementëve Velcro për të shtrënguar mëngën.

Buzët e lira të manshetave duhet të përshkohen nga një tegel perimetral linear një gjilpërësh sipërfaqësor.

Ndërkohë nga ekzaminimet e paraqitura të kryera nga laboratoritë e akredituar pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike rezultoi se mostrat e

paraqitura nga operatorët ekonomikë “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk kanë këto rezultate:

Artikulli xhup 3/4 me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës “Arisa Konfeksion”.

Jaka

Jaka është realizuar model Korean (drejtkendor) me kulmet perpara pak të harkuara. Lartësia e jakes e matur në qendren pas të saj është 10 cm. Hapja dhe mbyllja e jakes realizohet me ane të 2 butonave të montuar në borduren e jakes dhe zinxhirit me ngjyre të zeze në tonalitet me tekstin, i cili është në vazhdimësi në dy pjeset perpara.

Shpina

Shpina është realizuar me dy pjesë, të cilat bashkohen në drejtim vertikal përgjatë linjes qendrore pas me ane të tegelit qepes dy gjilperesh. Supanja e cila është aplikuar me vazhdim në pjeset perpara është e lire dhe është montuar vetëm në tegelin bashkues të jakes me trupin e xhupit dhe fiksuar skajet e saj. Në tegelin bashkues në anesor në lartësinë e belit janë montuar dy ylyqe (kalues) për kalimin e rripit të zi. Rripi është realizuar me tekstil dopio dhe përfundon me togez të zeze në njërën skaj.

Menget e xhupit

Menget janë realizuar me një pjesë secila; janë montuar me tegel një gjilperesh në tegelin e brendshëm të tyre dhe në kthimin e pales është përdorur gjithashtu tegel një gjilperesh. Ndërsa me trupin e xhupit menget bashkohen me tegel një gjilperesh dhe syzatorit. Në distance rreth 5.5 cm nga bordi fundor i secilës mëngë është montuar një gjuhez me tekstil dopio me lartësi rreth 5.5 cm për rregullimin e perimetrit të kycit të derës funksioni i të cilit kryhet me ane të butonave me veshje me ngjyre të zeze të montuar në spaletë dhe trupin e mëngës. Në distance rreth 7.5 cm nga koka e mëngës në secilën mëngë janë montuar velkroft “mashkull” për vendosjen e “Stemes së Gardës” dhe “Stemes së Republikës”.

Përfundime

Xhupi model 3/4 me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës është realizuar me materiale kryesore (tekstil i zi i papershueshëm nga shiu e era, veshje e e cmontueshme në formë jeleku me mbushje me vatine, astar i zi me mbushje me vatine) dhe materiale ndihmëse (frazeline për perforcimin e disa detaleve të xhupit) si dhe aksesoret sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Gjithashtu pjesa e modelimit dhe konfeksionimit janë realizuar në përputhje me specifikimet. Gjate matjes së dimensioneve të disa elementeve të xhupit u vu re që Xhepat e montuar në pjesën e gjoksit kanë dimensione 23 x 7.5 cm dhe jo 7 x 7.5 cm siç kërkohej në specifikime. Konfeksionimi është realizuar me tegelat qepes një dhe dy gjilperesh, të realizuara pa defekte sipas udhëzimeve të specifikimeve teknike. Në pamje të jashtme xhupi nuk paraqet defekte as në modelim as në konfeksionim.

Artikulli Xhup i shkurtes per punonjesit e Gardes se Republikes “Arisa Konfeksion”.

Jaka

Jaka eshte modeluar model koreane dhe eshte realizuar me dy shtresa tekstili te njejte me xhupin te perforcuar ne brendesi me frazeline. Jaka bashkohet me trupin e xhupit me tegel nje gjilperesh. Lartesia e jakes e matur pergjate qendres pas paraqet lartesi rreth 5 cm dhe ne dy skajet perpara jane montuar dy precino metalike “mashkull” “femer” per hapjen dhe mbylljen e saj.

Pjeset perpara (parset)

Xhupi eshte realizuar me dy pjese perpara. Hapja dhe mbyllja e xhupit realizohet me ane te zinxhirit te montuar ne brendesi te xhupit, pergjate gjithë gjatesise te pjeseve, i cili mbulohet nga nje bordure e realizuar me tekstil dopio me lartesi rreth 5 cm ku jane aplikuar dhe pese precinat “mashkull”, “femer”, dhe ne secilen pjese perpara jane montuar ne bordure dhe vazhdim ne jake 7 precino. Anet e lira te bordures ne te majte te veshur jane pershkuar me tegel nje gjilperesh.

Xhepat e montuar ne dy pjeset perpara nga jashte

Ne secilen pjese perpara eshte aplikuar nje xhep fileto me kapok i montuar ne drejtim diagonal. Kapaku eshte realizuar me tekstil dopio si ai i xhupit. Hapja e mbyllja e kapakut me xhepin fileto realizohet me ane te precinave metalike “mashkull-femer”. Xhepi ka hapje rreth 18 cm dhe ne brendesi eshte foderuar me astar me ngjyre te zeze.

Xhepat e montuar ne dy pjeset perpara ne brendesi te xhupit

Ne brendesi te xhupit te seciles pjese perpara ne astarin rrjete, ne lartesine e gjoksit jane montuar dy xhepa. Xhepat jane montuar ne drejtim horizontal dhe hapja dhe mbyllja e tyre kryhet me ane te zinxhirit me gjatesi 16 cm. Ne brendesi xhepat jane realizuar me astar dhe kane dimensione 15 x 22 cm.

Shpina

Shpina eshte realizuar me dy pjese, supanja deri ne linjen e shpatullave (karreja) dhe pjesa e poshtme. Pjeset bashkohen me ane te tegelit nje gjilperesh.

Menget

Menget e xhupit jane realizuar me dy pjese ne drejtim vertikal. Pjeset bashkohen me ane te tegelave nje gjilperesh te orjentuar: tegeli anesore ne gjatesi kundrejt aksit te brrylit ne anes, ndersa tegeli i poshtem me pikenisje nga pika nensqetulles ne gjatesi.

Kapaku - Mansheti i mengeve

Secila menge perfundon me nje manshet te realizuar me tekstil dopio te njejte me xhupin, i perforcuar ne brendesi me frozeline. Lartesia e manshetit eshte rreth 4 cm ne secilin kapak menge, ne tegelin bashkues te pjeseve eshte montuar nje gjuhez drejtkendore me tekstil dopio, ne skajin e lire te se ciles eshte montuar velkrof drejtkendor mashkull ne

korespondence me velkrofin femer te aplikuar ne kapak. Velkrofet jane montuar per rregullimin e e perimetrit te kycit te dores.

Konfeksionimi

Xhupi eshte konfeksionuar me ane te tegelave qepes nje gjilperesh dhe tegeli qepes dy gjilperesh i cili eshte aplikuar ne borduren perpara si dhe pastrimi i detaleve dhe pjeseve eshte kryer me syzator. Gjithashtu ne detale te caktuara eshte perdorur frazeline per perforcim (jake, kapake munge bordure kapak xhepi, bordure fundore). Jane perdorur aksesore si: precina metalike, zinxhir, si dhe materiale ndihmese (frazeline) per perforcim sic kerkohet ne specifikimet teknike.

Perfundime

Xhupi i shkurter dimeror (xhiboksi) per punonjesit e Gardes se Republikes eshte modeluar dhe konfeksionuar me te gjitha materialet kryesore, ndihmese dhe aksesoreve sic kerkohet ne specifikimet teknike. Ne pamjen e jashtme tegelat jane uniforme, nuk paraqesin defekte apo rrudhosje te tekstilit.

Artikulli kapele me dekoracionin e strehës për Gradën Gjeneral “Arisa Konfeksion”.

Kapelja e Grades Gjeneral eshte realizuar me material tekstile dhe elemente plastik si dhe dekoracione ne pjesen e strehes dhe Emblema.

Dimensionet e pjeseve dhe aksesoreve te kapeles

- *Streha lartesi strehe e matur ne pjesen qendrore 6.5 cm, ndersa ne pjesen anesore ka lartesi rreth 2.4 cm, trashesi strehe 2.5 cm.*
- *Shirit i kuq trashesi 3 mm,*

Dekoracionet

Lartesi dekoracioni ne ane 1 cm, e cila vazhdon duke u zgjeruar ne qender 2 cm,

- *Shirit plastik i zi perimetral ne pjesen e brendshme te kapeles me lartesi rreth 4.5 cm,*
- *Tel plastik i petezuar lartesi rreth 1.5 cm,*
- *Fashat (urat) lartesi fashe e matur ne pjesen frontale pergjate qendres 7 cm, ndersa ne pjesen pas lartesi rreth 4.5 cm,*
- *Pjesa e tepelekut te kapeles (pjesa e sipërme e pjerret) Gjatesia e matur pergjate qendres 28 cm,*
- *Kopsat metalike me ngjyre te arte 2 kopsa me dizenjimin e perkrenares se Skenderbeut dhe me shkrimin e harkuar “Garda e Republikes se Shqiperise”. Kopsa paraqet diameter 1.5 cm dhe trashesi rreth 3.5 mm.*

Perfundime

Kapelja me dekoracion per strehe per graden Gjeneral eshte modeluar, sipas specifikimeve teknike te kerkuara. Dimensionet e elementeve perberes te kapeles korrespondojne me dimensionet e kerkuara ne specifikime. Ne specifikime teknike eshte kerkuar qe te perdoret

astar me vrima per ajrim ne pjesen e brendshme te kapeles, ndersa astari i perdorur eshte tekstil pa vrima me ngjyre blu dhe jo te zi. Gjithashtu dhe fasha rrethore apo shiriti rrethor i vendosur ne brendesi te qemerit (shiritit) eshte material plastik pa vrima. Teli i petezuar eshte material plastik dhe jo metalik sic kerkohet ne specifikime.

Elementet e tjere dhe materialet ndihmese dhe aksesoret jane perdorur sipas specifikimeve teknike.

Artikulli xhup 3/4 me veshje të ngrohtë për punonjësit e Gardës së Republikës “Malbertex”.

Jaka

Jaka eshte realizuar model Korean (drejtkendor) me kulmet perpara pak te harkuara. Hapja dhe mbyllja e jakes realizohet me ane te dy butonave te montuar ne borduren e jakes dhe zinxhirit me ngjyre te zeze ne tonalitet me tekstilin, i cili eshte ne vazhdimesi ne dy pjeset perpara. Lartesia e jakes e matur ne qendren pas te saj eshte 10 cm.

Shpina

Shpina eshte realizuar me dy pjese, te cilat bashkohen ne drejtim vertikal pergjate linjes qendrore pas me ane te tegelit qepes dy gjilperesh. Supanja e cila eshte aplikuar me vazhdim ne pjeset perpara eshte e lire dhe eshte montuar vetem ne tegelin bashkues te jakes me trupin e xhupit dhe fiksuar skajet e saj. Ne tegelin bashkues ne anesor ne lartesine e belit jane montuar dy ylyqe (kalues) per kalimin e rripit te zi. Rripi eshte realizuar me tekstil dopio dhe perfundon me togez te zeze ne njerin skaj.

Menget e xhupit

Menget jane realizuar me nje pjese secila; jane montuar me tegel nje gjilperesh ne tegelin e brendshem te tyre dhe ne kthimin e pales eshte perdorur gjithashtu tegel nje gjilperesh. Ndersa me trupin e xhupit menget bashkohen me tegel nje gjilperesh dhe syzatorit. Ne distance rreth 4.5 cm nga bordi fundor i seciles mende eshte montuar nje gjuhez me tekstil dopio me fortesi rreth 5.5 cm per rregullimin e perimetrit te kycit te deres funksioni i te cilit kryhet me ane te butonave me veshje me ngjyre te zeze te montuar ne spalet dhe trupin e menges. Ne distance rreth 7.5 cm nga koka e menges ne secilen mende jane montuar velkrofet “mashkull” per vendosjen e “Stemes se Gardes” dhe “Stemes se Republikes”.

Përfundime

Xhupi model 3/4 me veshje te ngrohte per punonjesit e Gardes se Republikes eshte realizuar me materiale tekstili si dhe velkrofe e aksesoret sipas specifikimeve teknike te kerkuar. Gjithashtu pjesa e modelimit dhe konfeksionimit jane realizuar ne perputhie me specifikimet.

Ne ndryshim nga specifikimet teknike te kerkuara veshja e c'montueshme me mbushje me vatine dhe astari me mbushje me vatine nuk eshte modeluar ne forme romboidale, por ne forme shiritash ne drejtim vertikal.

Konfeksionimi është realizuar me tegelat qepes një dhe dy gjilperesh, të realizuara pa defekte sipas udhëzimeve të specifikimeve teknike.

Artikulli Xhup i shkurtër për punonjësit e Gardës së Republikës “Malbertex”.

Xhupi i shkurtër (xhiboksi) është realizuar me tre shtresa: tekstil i zi i papershkueshem nga era e shiu, veshje e brendshme e c'montueshme me ane të zinxhirit, me mbushje me vatine në formë romboidale me ngjyrë të zeze astar rrjete për aspirim me ngjyrë të zeze.

Jaka

Jaka është modeluar në formë koreane të ngritur dhe është realizuar me dy shtresa tekstili të njëjta me xhupin të perforcuar në brendësi me frazeline. Jaka bashkohet me trupin e xhupit me tegel një gjilperesh. Lartësia e jakës e matur përgjate qendrës pas paraqet lartësi rreth 5 cm dhe në dy skajet përpara janë montuar dy precino metalike “mashkull” “femer” për hapjen dhe mbylljen e saj.

Xhepat e montuar në dy pjeset përpara nga jashtë

Në secilën pjesë përpara është aplikuar një xhep fileto me kapok i montuar në drejtim diagonal. Kapaku është realizuar me tekstil dopio si ai i xhupit. Hapja e mbyllja e kapakut me xhepin fileto realizohet me ane të precinave metalike “mashkull-femer”. Xhepi ka hapje rreth 18 cm dhe në brendësi është foderuar me astar me ngjyrë të zeze.

Xhepat e montuar në dy pjeset përpara në brendësi të xhupit

Në brendësi të xhupit të secilës pjesë përpara në astarin rrjete, në lartësinë e gjoksit janë montuar dy xhepa. Xhepat janë montuar në drejtim horizontal dhe hapja dhe mbyllja e tyre kryhet me ane të zinxhirit me gjatësi 17 cm. Në brendësi xhepat janë realizuar me astar dhe kanë dimensione 18 x 23 cm.

Shpina

Shpina është realizuar me dy pjesë, supanja deri në linjen e shpatullave (karreja) dhe pjesa e poshtme. Pjesët bashkohen me ane të tegelit një gjilperesh. Në tegelin e shpines pas me vazhdim me tegelin e menges është nderfatur një fileto gri fosforeshente.

Bordura fundore

Xhupi perfundon me një bordurë të realizuar me tekstil dopio i perforcuar me frozeline me lartësi rreth 4 cm. Në dy pjesët anësore të xhupit në bordurë është aplikuar llastik për pershtatje të trupit.

Menget

Menget e xhupit janë realizuar me dy pjesë në drejtim vertikal. Pjesët bashkohen me ane të tegelave një gjilperesh të orjentuara: I pari në gjatësi kundrejt aksit të brrylit në anës, ndërsa tegeli i poshtëm me pikenisje nga pika e nensqetolles në gjatësi.

Kapaku - Mansheti i mengeve

Secila menge perfundon me nje manshet te realizuar me tekstil dopio te njejte me xhupin, i perforcuar ne brendesi me frozeline fortesia e manshetit eshte rreth 4 cm. Ne secilin kapak menge ne tegelin bashkues te pjeseve eshte montuar nje gjuhez drejtkendore me tekstil dopio, ne skajin e lire te se ciles eshte montuar velkrof drejtkendore mashkull ne korrespondence me velkrofin femer te aplikuar ne kapok velkrofet jane montuar per rregullimin e perimetrit te kycit te deres.

Perfundime

Xhupi i shkurter dimeror (xhiboksi) per punonjesit e Gardes se Republikes eshte modeluar dhe konfeksionuar me te gjitha materialet kryesore, ndihmese dhe aksesoreve sic kerkohet ne specifikimet teknike. Ne pamjen e jashtme tegelat jane uniforme, nuk paraqesin defekte apo rrudhosje te tekstilit.

Vihet re qe ne tegeline shpines pas me vazhdim me tegeline menges eshte nderfutur nje fileto gri fosforeshente, nderso ne specifikimet teknike nuk eshte kerkuar.

Artikulli kapele me dekoracionin e strehës për Gradën Gjeneral “Malbertex”.

Kapelja e Grades Gjeneral eshte realizuar me material tekstile dhe elemente plastik si dhe dekoracione ne pjesen e strehes dhe Emblema.

Dimensionet e pjeseve dhe aksesoreve te kapeles

- *Streha lartesi strehe e matur ne pjesen qendrore 6.5 cm, ndersa ne pjesen anesore ka lartesi rreth 2.4 cm, trashesi strehe 2.5 cm.*
- *Shirit i kuq trashesi 3 mm,*

Dekoracionet

Lrtesi dekoracioni ne ane 1 cm, e cila vazhdon duke u zgjeruar ne qender 2 cm,

- *Shirit plastik i zi perimetral ne pjesen e brendshme te kapeles me lartesi rreth 4.5 cm,*
- *Tel plastik i petezuar lartesi rreth 1.5 cm,*
- *Fashat (urat) lartesi fashe e matur ne pjesen frontale pergjate qendres 7 cm, ndersa ne pjesen pas lartesi rreth 4.5 cm,*
- *Pjesa e tepelekut te kapeles (pjesa e siperme e pjerret) Gjatesia e matur pergjate qendres 28 cm,*
- *Kopsat metalike me ngjyre te arte 2 kopsa me dizenjimin e perkrenares se Skenderbeut dhe me shkrimin e harkuar “Garda e Republikes se Shqiperise”. Kopsa paraqet diameter 1.5 cm dhe trashesi rreth 3.5 mm.*

Konfeksionimi

Kapelja eshte realizuar me tekstil dhe materiale plastike, ndaj per prodhimin e saj jane perdorur makina speciale dhe tegelat per bashkimin e pjeseve jane nje gjilperesh si dhe tegel dekorativ ne brendesi ne pjesen e shiritit plastik.

Përfundime

Kapelja me dekoracion per strehe per graden Gjeneral eshte modeluar, sipas specifikimeve teknike te kerkuara. Dimensionet e elementeve perberes te kapeles korrespondojne me dimensionet e kerkuara ne specifikime. Ne specifikime teknike eshte kerkuar qe te perdoret astar me vrime per ajrim ne pjesen e brendshme te kapes, ndersa astari i perdorur eshte tekstil pa vrime me ngjyre blu dhe jo te zi. Gjithashtu dhe fasha rrethore apo shiriti rrethor i vendosur ne brendesi te qemerit (shiritit) eshte material plastik pa vrime. Teli i petezuar eshte material plastik dhe jo metalik sic kerkohet ne specifikime.

Gjithashtu kordoni eshte montuar mbi nje shirit me ngjyre te arte deri ne anesor ndersa ne specifikime teknike nuk rezulton shirit me ngjyre te arte.

Komisioni Prokurimit Publik nga sa më sipër vlerëson se nga ballafaqimi i rezultateve të ekzaminimeve të kryera nga laborator i Universitetit Politeknik të Tiranës me specifikimet teknike për zërat e mostrave të kontestuara nga operatori ekonomik ankimues, gjykon se autoriteti kontraktor, me të drejtë ka kualifikuar operatorët ekonomikë “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk, pasi mostra e paraqitura prej tyre pasi ju nënshtruan edhe ekzaminimeve nga laborator i Universitetit Politeknik të Tiranës rezultojnë se janë në përputhje me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht mostrat lidhur me *xhupin $\frac{3}{4}$, xhupin e shkurtër dhe kapelen me dekoracionin e strehës për gradën Gjeneral* kanë të njëjtat *materiale ndihmëse të njëjtën mënyrë qepje për jakën, shpinën, mëngët xhepat e përparëm, pjesa e pasme, bordurat e poshtme, manshetat si dhe dimension dhe dekoracion*, sipas përcaktimeve në specifikime teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi për këto artikuj.

Në rastin konkret, Komisioni referuar raport ekzaminimeve të kryera nga inxhinieri z. G. G nga departamenti tekstilit dhe modës pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, më datë 12.04.2021, si dhe seancës dëgjimore të zhvilluar pranë ambjenteve të KPP më datë 30.04.2021 në prani të ekspertit G. G lidhur me disa paqartësi në përmbajtjen e raport ekzaminimit, gjykon se mostrat e paraqitura nga operatorët ekonomik “Arisa Konfeksion” shpk dhe “Malbertex” shpk të analizuar nga eksperti G.G pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, konsiderohen se janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Ndërsa lidhur me rezultatin e ekzaminimeve për pjesët e tjera përbërëse të mostrave objekt ankimi për të cilat inxhinieri z. G. G pranë Universitetit Politeknik të Tiranës është shprehur por që janë përtej kërtimeve të Komisionit Prokurimit Publik në kërkesën drejtuar UPT, dhe përtej pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik, nuk shprehet më tej lidhur me këto konkluzione të arritura gjatë ekzaminimit, përse kohë që ato nuk kanë qënë objekt kërkesesh nga KPP, por edhe vetë ankimuesi nuk ngren pretendime në lidhje me to.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Gentian Sadiku”, PF shpk nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” P.F për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur, me Nr. REF-78186-11-10-2020, me objekt “Blerje uniformash dhe elementësh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës”, me fond limit 18,000,120 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 04.12.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1826 Protokolli, Datë 30.12.2020.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri